



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **22.11.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Draft planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Draft planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për miratimin e Draft planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2022.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë kam një pikë shtesë dhe propozimi im është për mocionin e votëbesimit të kryesuesit. Mendoj se ishte shaka dhe për këtë ju falënderoj për punën e mrekullueshme që keni bërë si kryesues gjatë këtij mandati.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Hoxha, e qesim në votim rendin e ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Atëherë meqë nuk kemi të lajmëruar sa i përket procesverbalit, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë. Po e vërej se drejtori i shërbimeve publike po mungon sot në mbledhje, kështu që pyetjen ju adresoj juve kryetar. Në rrugën Gëzim Hamza gjendet një ordinancë e radiologjisë por në atë rrugë është e ndaluar parkingu edhe për pak minuta dhe aty kam hasur në disa pacientë që kanë vështirësi në lëvizjet fizike. Rruga është e ndaluar për 150 metra afërsisht, kështu që a keni menduar

për ata pacientë që e vizitojnë atë ordinancë që e kanë të pamundur me lëvizë pasi duhet me parkua veturën krejt diku tjetër dhe me pastaj me shkua ne ordinancë dhe kjo realisht e vështirëson edhe me shume këtë.

Rukije Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin ,anëtarët e kuvendit që janë në përfundim të vjetër dhe shume suksese këshilltarëve të rinjë që do të vinë, kështu që unë kam një propozim për kryetarin dhe kryesuesin. Meqenëse jemi në përfundim të mandatit dhe është mbledhje e fundit e kësaj legjislature, propozimi im është kryetarin dhe kryesuesin që e ka mundësi për ndonjë mirënjohje për këshilltarët që kanë me shume se 3 mandate dhe që të jetë kjo edhe si rregull për legjislaturat e ardhshme që janë kontribuues mbi një dekadë, kështu që le të jenë ata sado pak e meritojnë për kontributin e tyre që e kanë për një dekadë rresht. Gjithashtu propozimi i dytë është për koleget asamblastë ju falënderoj të gjithëve për kontributin dhe mirëkuptimin dhe gjithashtu kërkoj falje ndonjëherë për fjalorin e ashpër sepse natyra e punës opozitë pozitë ndonjëherë jemi gjendur në situata të tilla, kështu që i falënderoj të gjithë për bashkëpunimin mirëkuptimin. Dhe e treta është një urim dhe suksese për kryetarin dhe qeverinë e re që do të formohet, pasi jeni kryetari që keni me qenë në histori për punën dhe kontributin sepse jeni person që ecni me hapa gjigant që rrallë kush mundet me ecë paralel me ju dhe gjithashtu edhe për vështirësitë që kanë edhe drejtorët që kanë ndaj ju, por edhe këta i uroj për suksesin dhe durimin për punën dhe angazhimin që bëni në qeverisjen komunale sepse keni dhënë maksimumin në rregullimin e mirëqenies dhe lehtësimin e jetës së qytetarit, megjithatë mundësit dhe përpjekjet e juaja se bashku me drejtorët. Kështu që urime dhe sukses në legjislaturën e ardhshme.

Refki Kryeziu - Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, koleget asamblastë.. Meqenëse për mua personalisht kjo është mbledhja e fundit e kësaj legjislature dhe gjithashtu mbledhja e parë pas zgjedhjeve, unë desha të i uroj kryetarit për mandatin e ardhshëm 4-vjeçar e gjithashtu edhe asamblastët që do të vinë, duke i dëshiruar ti realizoj ato që i ka premtuar gjatë fushatës, gjë të cilën nuk dyshoj në premtimet e tij dhe suksese të gjithëve.

Kryetari – I nderuar kryesues I kuvendit të komunës z. Afrim Dina, nënkryetar I komunës z. Fatmir Iska, drejtor të drejtorive, anëtar të kuvendit të komunës, përfaqësues të mediave, monitorues të tjerë të kësaj seance të fundit në këtë përbërje dhe shume faleminderit për bashkëpunimin tuaj. Në pyetjen e drejtuar nga Shqipe Kryeziu rreth një shqetësimi që realisht nuk jam shume i saktë dhe nuk po dua me komentua por sigurisht se do të interesohem pasi aty është ordinance e Sadri Beqirit dhe e di që ka hapësirë të pamjaftueshme pasi nuk është rrugë me standarde të duhura dhe të shohim çka mundemi me bo aty që me vendos ndonjë shenjë aty dhe e kuptojmë nevojën dhe shqetësimet që kanë pacientet aty por duhet me pa edhe nga pikëpamja apo këndvështrimi tjetër sigurisht se edhe në bashkëpunim edhe me policinë se a duhet me pas edhe shenjë tjetër apo jo, por sidoqoftë do të interesohem sot rreth kësaj teme. Pastaj pyetja e parashtruar nga Rukije Krasniqi, sigurisht se jam dakord që mirënjohje me marr të gjitha ata që i kanë shërbyer komunës së Rahovecit në cilësinë e përfaqësuesit të zgjedhur anëtarëve të kuvendit dhe gjithashtu jam dakord që me ju dhanë edhe atyre që janë përsëri përfaqësues të zgjedhur në këto zgjedhje por edhe atyre që nuk kanë konkurrar apo nuk kanë pasur mundësi që të jenë pjesë e kësaj legjislature. Kështu që nga sot do të kujdesemi që të i bëjnë mirënjohjet pasi edhe kjo seance është paska me ndryshe, ku pas kësaj seance kryesuesi me ekipin ka vendosur me vlerësua simbolikisht punë tonë të përbashkët si kuvend i komunës, Kështu që e falënderoj edhe Rukijen por edhe të gjithë ata që kanë shërbyer që nga paslufta në cilësinë e përfaqësuesit të zgjedhur në kuvendin e komunës dhe sigurisht se meritojnë me shume se sa një mirënjohje dhe madje jam që të vlerësohen me mirënjohje edhe ata që kanë qenë edhe për vetëm një mandatë pasi edhe i japim edhe kuptim punës së kuvendit dhe përtej propozimit të Rukijes për mirënjohje, unë propozoj që në njërin pjesë të sallës së kuvendit me i vendos edhe fotografit e kryesuesve të kuvendit të komunës që nga paslufta, që me siguri e keni parë neper shtete të ndryshme të Evropës neper komuna vendosen fotografit e udhëheqësve për periudhën që

ka udhëhequr kuvendin e komunës. Historia është shume me e hershme por kuvendi i kuvendit te komunës se Rahovecit për mua fillon nga viti 1999, kështu që ne duhet me i vendos fotografit e personaliteteve që kanë udhëheq kuvendin e komunës ne këtë sallë ne Kosovën e lirë. Kështu që edhe njëherë faleminderit për urimet dhe nëse ka ndonjë pyetje sigurisht se këtu jam edhe do te mundohem te jap përgjigje dhe gjithashtu i uroj te gjithë ata që janë zgjedhur dhe gjithashtu do te vazhdoj te mbaj një komunikim jashtëzakonisht te sinqertë edhe me ata që nuk kanë konkurruar apo nuk kanë mbërri mjaftueshëm që te jetë pjese e legjislaturës dhe kam si obligim edhe si njeri edhe si kryetar i komunës që te sillem konfom një normative që ne thelbojmë ka elementin njerëzor. Faleminderit te gjithë për bashkëpunim dhe pavarësisht ndonjë përplasje që kemi mundur me pas sigurisht se kanë qenë me qëllimin e mirë ne dobi te kontributit te përgjithshëm, pasi jemi njerëz te pjekur dhe sigurisht se e mirëkuptoj edhe Rukijen, pasi vazhdimisht si kryetar i komunës kam qenë i sfiduar por edhe ekipi im ka qenë i sfiduar qoftë nga vërejtjet e kritikave që kemi marr nga ky kuvend që na kanë shërbye me cilësua kualitativisht punën tonë qofte edhe nga sfidat që kemi pasur edhe ne funksion te përmbushjes se obligimeve te kuvendit por edhe obligimeve tona që i kemi paraqit qytetareve por edhe zotimeve tona apo prioritetet gjatë këtij mandati dhe shpresoj që do te vazhdojmë edhe tash e tutje kështu.

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar, meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar për këtë pikë, kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit te Draft planit te punës se Kuvendit te Komunës për vitin 2022.

Kryesuesi - I nderuar kryetar, te nderuar anëtar te kuvendit, si çdo here ne përfundim te vitit kuvendi propozon dhe aprovon planin e punës te kuvendit për vitin pasues e ne këtë rast vitin 2022, ku ne çdo vit kemi pasur takime dhe kemi bërë edhe koordinimin për planin e punës se kuvendit nga drejtoret e drejtorive komunale, anëtarët e komitetit për politikë dhe financa, anëtarët e komitetit për komunitete dhe te gjithë se bashku e kemi hartua planin e punës se kuvendit dhe këtë vit pasi që ishim edhe ne vite zgjedhor e kemi sjellë draftin e planit te punës se kuvendit i cili pikat standarde te planit te punës se kuvendit siç janë Procesverbali, pyetjet dhe përgjigjet dhe ne fund janë shqyrtimet e informatave apo kërkesat e asamblistëve apo anëtarëve te kuvendit. Gjithsesi ne bashkëpunim edhe me drejtorit ne draftin që ju e keni përpara, e kemi shqyrtuar edhe ne mbledhjen e komitetit për Politike dhe Financa që e kemi pasur dhe i kemi propozua kuvendit që ky plan i punës te aprovohet. Nuk kemi mundur me lan për mbledhjen tjetër për shkak se është mbledhja e fundit e kësaj legjislature dhe nuk guxojmë te hyjmë ne vitin tjetër pa plan te punës . nëse ka dikush diçka sa i përket planit te punës atëherë do ta shohim se bashku edhe e shqyrtojmë. Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar sa i përket pikës se tretë te planit te punës se kuvendit, e qesim ne votim pikën e tretë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit te draft planit te punës se Kryetarit të Komunës për vitin 2022.

Kryetari – Në bashkëpunim me ekipin e drejtoresve por edhe kuadrove tjerë, ne kemi hartuar një plan te punës se kryetarit te komunës dhe ekipit te tij për vitin 2022 mirëpo ky dokument pastaj ju ka nënshtruar procedurës se dëgjimeve publike dhe konsultimeve publike, le te konstatohet edhe ne procesverbal pasi ju ka nënshtrua edhe kësaj procedure sipas ligjit dhe vlerësoj që plani i punës për vitin 2022 natyrisht që është një plan që ju ka nënshtrua edhe aspekteve te tjera që lidhen me vizionin 4 vjeçar pasi mund te shihni edhe elemente te reja, prioritet, zotime, qëllime, synime etj. Ky dokument përmban aspektet konkrete detyrat përgjegjësit qëllimet që nga zyra e personelit, zyra ligjore, zyra e kryetarit te komunës, drejtoritë përkatëse duke përfshije edhe zyrën komunale për komunitete dhe po ashtu edhe vizioni i kryetarit te komunës dhe ekipit te tij për vitin 2022 që ne thelbojmë përmban vazhdimësinë por njëkohësisht i ka edhe aspektet e tjera te cilat lidhen me vizionin që e kemi shpalosur gjate fushatës. Plani është ambicioz por normalisht është edhe i realizueshëm për shkak se ne tash ne mase te madhe ka vazhdimësi por ka edhe elemente te reja dhe prioritetet te cilat synojmë me i nisë ne vitin 2022. Unë e di që ka plot arsye për debat dhe e di që plot prej juve dëshirojnë edhe me marr fjalën sepse ky plan pas dëgjimeve publike i nënshtrohet edhe debatit ne kuvendin e komunës. Besoj që ne edhe këtë vit

pavarësisht se ishte vit i ngarkuar me komponentin e fushatës por ne jemi te sigurt se po i kryejmë ne aspektin ligjor veprimet tona edhe sa i takon planit te punës se kuvendin edhe sa i takon planit te punës se kryetarit te komunës dhe ekipit te tij pastaj planit te punës se KKSBB-së dhe po hyjmë ne vitin 2022 me punë te kryera që besoj që edhe monitoruesit si MAPL-ja dhe organizatat tjera do te na gjejnë te përgatitur dhe nuk mund te gjejnë ndonjë situatë apo zbrastësi ku ne kemi mundur me heqë dorë apo me braktisë punën tonë ne komunë për shkak te nevojave apo kërkesave që ka pasur fushata parazgjedhore. Kështu që jam i lumtur që kemi mbërrirë me kohë dhe ne mbledhjen e fundit ne këtë përbërje te mbërrimë me kohë që ta miratojmë edhe planin vjetor te punës se kuvendit për vitin 2022 por edhe besoj edhe propozim planin apo draft planin te kryetarit te komunës dhe ekipit te tij për vitin 2022. Unë mundem me fol rreth planit mirëpo ju dokumentin e keni para vetes dhe besoj që e keni marr me kohe, kështu që jam i gatshëm dhe i hapur për diskutim, për ndonjë paqartësi vërejtje kritike plotësim që keni.

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar, a ka dikush diçka sa i përket pikës se tretë te rendit te ditës.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët që janë prezentë, kolegë asamblastë dhe gjithë te pranishmit ne sallë. E dëgjuam ne pika te shkurta elaborimin e programit te punës se kryetarit për vitin 2022 dhe unë e kam lexuar me kujdes dhe mendoj se është një plan i gjerë dhe gjithëpërfshirës për te gjitha drejtoritë dhe uroj që për vitin 2022 ky plan te zbatohet edhe ne praktike që do të ishte shume mirë edhe ne interesin e komunës tonë dhe qytetarëve tanë. Unë dua te kontribuoj me dy pyetje sa i përket kësaj pike te rendit te ditës, sa i përket drejtorisë për shëndetësi dhe drejtorisë për kulturë rini dhe sport. Pra ne faqe 13 kemi drejtorin për shëndetësi nuk kam ndonjë vërejtje, mendoj se është një plan i mire dhe gjithëpërfshirës por ajo që unë kisha me plotësuar është kjo, pasi është një kategori e qytetareve ne çdo komunë por edhe ne komunën tonë që kanë probleme sa i përket shëndetit mendor, ku janë shënuar disa hapa pozitiv ne përkujdesin e këtyre qytetareve por nuk është mjaftueshme dhe është koha kur komuna jonë duhet me marr një përgjegjësi me te madhe ne kuptimin e mbrojtjes dhe kujdesit shëndetësor ne këtë kategori pra kategoria e qytetareve e shëndetit mendor, pasi është një numër goxha i madhe dhe është barrë e madhe për familjet e tyre pasi kryesisht janë ne përkujdesin e familjeve te tyre , kështu që komuna jonë duhet te angazhohet pak me tepër sa i përket kësaj kategorie pasi edhe me ligj lejohet që komuna me pas qendrën e shëndetit mendor bazuar ne bashkësi ku ata do ta kenë qëndrimin e tyre ditor pastaj do te kenë kujdesin shëndetësor, furnizimin me te mire me ilaqe dhe gjithashtu ajo qe është e rëndësishme përkujdesi ditor që dikush ne aspektin institucional te përkujdeset për këtë individ apo qytetar pasi vërtet janë barrë e madhe për familjen e tyre jo vetëm ne aspektin material por edhe ne aspektin psikologjik me shume dhe mendoj se ne këtë mënyrë do te ju dilnim ne ndihmë kësaj kategorie jo vetëm atyre por edhe gjithë shoqërisë. Pra kisha desha që kjo filloj te behet diçka brenda mandatit qysh ne fillim te vitit 2022 që te ndahet buxhet dhe te behet diçka ne këtë drejtim.

Tek drejtoria për kulture rini dhe sport është një çështje që e kam potencuar edhe herëve tjera , si përkujdesi dhe mbrojtja e monumenteve te trashëgimisë kulturore historike pastaj e arkitektur, ku drejtoria ne fillim e ka cekur se hartim te projekteve për ruajtjen e trashëgimisë historike dhe kulturore por nëse shikojmë planin e drejtorisë atëherë vetëm ne një pikë ceket ne faqe 27 tek 3 mujori i dyte prill maj qershor ku pika e 4 thotë organizim te aktiviteteve për nder te ditës se monumenteve kulturore dhe historike. Mendoj se nuk mjafton pasi me këtë mendohet vetëm një ditë brenda vitit do te shqyrtohet çështja e këtyre monumenteve, kështu që unë mendoj se është shume me rëndësi edhe për faktin se ato i nënshtrohen shkatërrimit te kohës pastaj faktori njeri po i shkatërron ato edhe ashtu pasi ato pak monumente që i kemi pasur edhe janë shkatërruar nga koha dhe mos lejohet te intervenohet por me shume te punohet. E kam potencuar edhe me përpara se komuna duhet te formoj një grup që do te bënte identifikimin e t gjitha këtyre objekteve te kësaj rëndësie duke përfshije edhe monumentet natyrore ku duhet saktë te evidentohen dhe te regjistrohen dhe te futen te paktën ne mbrojtje te nivelit qendror por sigurisht edhe komuna te i merr ato ne mbrojtje pasi tek e fundit janë për komunën tonë pora qytetaret tanë.

Munib Durguti – Të nderuar kryesues, kryetar, kolege asamblastë, drejtor te drejtorive dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Fillimisht e uroj kryetarin e për zgjedhjen e mandatit te dytë dhe njëkohësisht te gjithë kolegeve

asamblistë që e kanë fituar besim qytetar që te përfaqësojnë ne mandatin e ardhshëm. Sa i përket planit të punës, kemi një plan shumë voluminoz i cili përfshin në vete të gjitha ato aktivitete që e shohim që janë të ndara në periudha dhe synimet kryesore për vitin 2022. Ajo që bie në sy duke e krahasuar me planin e vitit 2021, që por ndërlidhem pak edhe me diskutimin e doktorit ku mungon qendra e dializës, ku kemi bërë shumë debate në këtë mandat dhe po e kuptojmë natyrën e problemit që nuk varet vetëm prej komunës tonë pasi është e ndërlidhur edhe me qarqe tjera e në këtë rast Ministria e Shëndetësisë dhe shërbimi spitalor klinik universitar mirëpo nëse e heqim komplet ashtu siç është në draft planin e kryetarit atëherë po i bjen se ne po heqim dorë prej një projekti që komuna ka investuar në të kaluarën mjaft shumë. Unë kisha propozua që në kuadër të synimeve të paktën të shkruhet funksionalizimi i qendrës së dializës në Rahovec dhe kjo nuk është e tepërt dhe nëse japim premtim atëherë mundemi prapë me deshtë siç e thash se nuk varet vetëm nga ne ekskluzivisht por duhet të paktën duhet të jetë e shënuar në kuadër të synimeve.

Kryetari - Ne kemi bërë diçka në evidentimin dhe historiatin e objekteve të trashëgimisë të monumenteve të natyrës e të monumenteve të tjera të trashëgimisë kulturore historike dhe nuk do të ndalemi asnjëherë për me sigurua që ato të kenë me shumë mbrojtje, sigurisht që do të ketë meremetime rinovime konservime. Ne nuk kemi shumë ekspertizë në këtë drejtim dhe qysh tash jemi duke vazhduar në trajtimin e mullirit Hoxhajve si dhe një mulliri tjetër, por nga viti 2022 e tutje duhet të fokusohemi me shumë edhe në investime edhe në mirëmbajtje edhe në mbrojtje qoftë nga komuna apo në koordinim edhe nga shteti që do të ishte me se miri edhe në meremetim konservim por edhe në menaxhim me të mirë pasi kemi shumë sfida dhe nuk po mundemi me angazhua njerëz për shkak të kufizimeve që i kemi nga shteti dhe po duhet me gjet forma që me i përfshijë njerëzit përmes kontratave mbi vepër kurse tash po duhet përmes prokurimit që me qenë me të vëmendshëm në menaxhim por edhe në mirëmbajtje si dhe aspekte tjera që ndërlidhen me trashëgiminë. Sa i takon qendrës së shëndetit mendor, kam menduar që qendra e shëndetit mendon në Gjakovë është jo vetëm për qëndrim ditor por nuk ish ashtu siç kam menduar. Pra ne do të shohim që të bëjmë edhe vet një qendër të shëndetit mendor këtu në Rahovec dhe për këtë kam biseduar edhe me këta të qendrës për punë sociale edhe pse nuk e kam futur në programin qeverisës për 4 vjet por vetëm e kam cekur bashkëpunimin dhe koordinimin me të mirë duke menduar se neve nuk na takon që të bëjmë një qendër të shëndetit mendor në Rahovec dhe në momentin që gjejmë një lokacion të përshtatshëm dhe diku e kemi një ide atëherë pse mos me pas një objekt të shëndetit mendor këtu dhe ku do të angazhoheshin edhe psikolog infermierë që gjatë orarit të punës ta kenë shërbimin e nevojshëm në atë qendër dhe pas orarit të punës të ju kthehen familjeve të tyre, Pra mendoj se do ta fusim si prioritet që i duhet qytetit të Rahovecit sepse ne kemi shumë probleme me këtë kategori të qytetareve që kanë probleme me shëndetin mendor dhe nuk po ka kapacitet qendra e shëndetit mendor në Gjakovë me i trajtue në mënyrën ashtu siç kërkohet e sigurisht edhe të resurseve të pamjaftueshme edhe atje dhe ndoshta edhe për shkak të bashkëpunimit jo të mirë që ekziston mes neve edhe atyre. Sa ka qenë doktor Ismet Bardhoshi ka shkue ndoshta me mirë mirëpo tash ai ka dalë në pension dhe ka ardhë dikush tjetër dhe me gjasë nuk ka funksionon ashtu siç duhet. E përmendi edhe Munibi qendra e repartit të Hemodializes që është një investim i mirë që e ka bërë komuna e Rahovecit dhe sfidat e mos funksionalitetit të këtij reparti besoj e dini të gjithë, që edhe njëherë po e shfrytëzoj rastin me i bo thirrje Ministrisë së shëndetësisë ta marrë vendimin e shumëkërkuar e shumëpritur nga ana e jonë, që njëkohësisht e ftojë edhe spitalin rajonal të Prizrenit që të ndërmerr veprimet e nevojshme për rekrutimin e stafit profesion dhe unë kërkoj që[ne emër të qytetareve kam të drejtë me ju than se stafi i Rahovecit është jashtëzakonisht i përgatitur dhe reparti i hemodializes është] gati mirëpo ne nuk kemi guxim me marrë përsipër edhe me hap vet repartin e hemodializes pa a pyetur askënd pasi që bartin përgjegjësi jashtëzakonisht ta madhe pasi është shërbim sekondar apo terciar edhe sigurisht se duhet mekanizma të tjerë të përfshihen në proces në mënyrë që edhe të funksionalizohen edhe të mirëmbahet por edhe sigurisht të krijohet siguria e nevojshme për pacientë që marrin shërbime aty. Pra nga këtu i apeloj ministrit të ri të shëndetësisë pasi vërtet është shumë serioz në punën e tij dhe ka marrë lëvdata nga të gjitha partitë politike në Kosovë pasi është një profesionist i mirë dhe nga një qendër e rëndësishme spitalore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ku ka treguar edhe atje suksese të jashtëzakonshme dhe shpresoj që ka mundësi të mëdha me ardhë deri të vendimi i shumëpritur dhe i shumëkërkuar nga ana e jonë për hapjen e

repartit të hemodializes por duhet ta dini që vendimin për hapjen përkohësisht për ta mbyllur, unë nuk i jap vetes të drejtë me u tall pasi ka pasur një tentim apo përpjekje me hap repartin për kohe pandemie dhe me ardhë edhe qytetar prej komunave tjera dhe me pastaj në një moment të caktuar me mbyll dhe këtë vendim nuk e kam pranuar nga ana e ministrit për shkak se nuk kanë ofruar asnjë siguri që do të ketë një funksionalizim dhe hapje afatgjate të këtij reparti. Kështu që tash nëse kemi mundësi me hap edhe mos me mbyll do të jetë tepër e rëndësishme edhe krejt kushtet kriteret e standardet i plotëson reparti i hemodializes në Rahovec, kështu që unë do të hie në kontakt me ministrin e ri të shëndetësisë dhe do të kërkoj edhe në emër të juajin pasi disa here është diskutuar edhe në kuvend nga ju por edhe në emër të qytetareve e mbi të gjitha në emër të atyre që kanë nevojë me marr shërbime afër këtu dhe të ndërmerren hapa konkret e të sigurt që të hapet reparti i hemodializes në Rahovec. Kështu që i nderuar Munib Durguti e kam një nga top prioritetet e kam edhe hapjen e repartit të hemodializes, por në programin që e kam prezantuar që bëhet si program i qytetareve të komunës së Rahovecit që në kemi detyrim me zbatu ku thuhet aty si insistim këmbëngulës për hapjen e repartit të hemodializes në Rahovec, kështu që tash kemi insistim me afate që ose duhet me hap ata ose në duhet me tregua se çka do të bëjmë me atë repart që i ka të gjitha pajisjet në rregull. Pra ju ftoj që me këto vërejtje dhe plotësime që janë reale të hidhet në votim dhe të miratohet plani vjetor i punës për vitin 2022, paraprakisht duke ju falënderuar edhe njëherë të gjitha grupet politike të përfaqësuara në kuvend por edhe ata që janë të pavarur pastaj shefat e grupeve politike që keni kryer shumë punë në kuvend që ka nxjerr shumë rregullore dhe akte normative dhe ka miratua shumë vendime që ju kanë shërbye qytetareve të komunës së Rahovecit. Sipas planeve vjetore të kuvendit të miratuara çdo vit kurrigjë nuk i ka mbet kuvendit të komunës që me mbet peng i ndonjë pune të pakryer dhe gjithashtu ekipi qeverisës nuk ka mundur me i krye të gjitha punët por kuvendi i komunës e ka krye punën e vet teksa ka vendos në shumëçka që ka ardhë si material si pika të rendit të ditës dhe sigurisht se ju falënderoj paraprakisht.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit në sallë. E falënderoj kryetarin për ofrimin e draft planit të punës së kryetarit për vitin 2022, që është një plan gjithëpërfshirës dhe sigurisht se ka mjaft që të punohet për vitin 2022 por unë desha me potencua që plani është i mirë por kisha kërkuar që edhe me u zbatua përpikërisht edhe brenda mundësive buxhetore dhe kapaciteteve njerëzore, që dua të marr një shembull pasi shoh tek drejtorja e arsimit që ka paraparë shumë gjëra qoftë mbajtja e testeve pastaj furnizimi me tekste shkollore pastaj furnizimi i bibliotekave etj. që do të veçoja njërin prej tyre ku thotë që do të bëhet furnizimi me lende djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukative arsimore para muajit nëntor dhe do të përcjellët vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale. Do të ishte mirë që këto përgjegjësi të mbahen ashtu siç janë të shkruajtura këtu sepse për këtë vit kemi mjaft vërejtje të furnizimi i shkollave me lende djegëse pasi nuk ka ndodhur në kohën dhe në momentin e duhur pasi kemi fëmijët tanë dhe tani veçse koha është ftohur dhe e kanë shumë vështirë të mbajnë procesin mësimor për shkak se disa shkolla nuk kanë dru për nxemje. Kështu që e potencova qëllimisht që ti përmbahemi planit, e kuptoj se ka mjaft procedura që duhet të përmbushen por nxënësit duhet që duhet të kenë kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Kryetari – Kontrata për furnizim me dru neper shkolla është lidhur me shumë vonesë për shkak të ankesës që e ka dikush dhe për shkak të mungesës së bordit të OSHP-së. Procedura mundëmi me konfirmua që ka nisur me kohë mirëpo vonesat në këtë vit kanë qenë evidente për shkak të mosfunksionimit të organit shqyrtues të prokurimit I cili organ nuk është funksional pasi anëtarët e këtij organi zgjidhen nga parlamenti I Kosovës, që edhe tash kemi shumë problem në disa kontrata jo vetëm komuna jonë, kështu që për këtë kërkoj ndjesë që për shkak të kësaj situatë ka pasur telashe nxënësit dhe mësimdhënësit tanë neper disa shkolla. Në disa shkolla ka pasur edhe rezerva por në disa shkolla nuk ka pasur dhe sigurisht se kanë pasur edhe telashe. Pra unë pajtohem plotësisht me ato që i tha Rasimi që plani nuk është mirë të mbesin në letër por duhet të zbatohen ndërsa vështirësitë e procedurave pasi kemi një plan vjetor të prokurimit që duhet me zbatu mirëpo në nuk kemi kurrfarë sigurie përderisa kemi organe të cilat merren me vlerësimet e ankesave e sidomos kur mungon një organ që rolin si gjykatë e tenderëve si OSHP-ja atëherë vështirësitë akoma me shumë shtohen.

Pra ju falënderoj te gjithë për angazhimin dhe vërejtjen që dhe z. Rasim Fazliu pasi vërtet është vërejtje me vend, kështu që ju ftojë që te miratohet me votë plani i kryetarit te komunës dhe ekipit te tij për vitin 2022.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, e qesim ne votim pikën e katërt te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për miratimin e draft planit te punës të Këshillit komunal për siguri ne bashkësi (KKSB) për vitin 2022.

Kryetari – Siç e dini KKSB-ja është një organ i rëndësishëm i komunës se Rahovecit ku përfshihen përfaqësues te sektorëve kyç nga shoqëria civile por edhe nga pakicat por edhe nga kleri fetar që diskutojnë dhe angazhohen që me u sigurua që ne komunitet te kemi stabilitet dhe siguri, pra bëhen përpjekje ne vazhdimësi dhe kjo çështje është e rregulluar me ligj. kështu që si drejtues i KKSB-së që 4 vjet sipas një plani që paraprakisht hartohet pastaj konsultohet si draft dhe me KKSB-në por edhe ne debat publik por edhe me mekanizma që janë relevante .Ky plan për vitin 2022 ka ardh dhe ne këtë proces merr pjesë edhe OSBE-ja dhe organizata te tjera që kryesisht trajtojnë tema dhe çështje te sigurisë. Ky plan është para jush dhe besoj që edhe nga kjo pikëpamje kur e shtrojmë çështjen po hymë ne vitin 2022 pastër sa i përket dokumenteve te miratuara ne kuvend te komunës. Brenda vitit mbahen deri ne 6 mbledhje te KKSB-së pasi është një organ specifik dhe shume i rëndësishëm dhe ky plan parasheh ne çdo mbledhje se çka do te mbahet si ne muajin janar, mars, prill, qershor, shtator dhe nëntor. Pra parashihen për 6 mbledhje pika te caktuara te rendit te ditës ku përfshihen ku bazohen ne rrethana apo proceset apo situatat që parashihet te kaloj komiteti apo qytetaret e komunës se Rahovecit gjate një viti kalendarik. Nëse keni ndonjë propozim ide plotësim sigurisht se do i bëni mirë edhe këtë plani por edhe atyre që do të përfshihen ne 4 vjeçarin e ardhshëm si anëtar te ri te KKSB-së. Pra me këtë mandat përfundon edhe mandati i KKSB-së dhe tek ne janar pritet me u shpall thirrjet për aplikime te reja për te gjithë ata që mendojnë se munden me kontribuuu ne KKSB, por tani planin megjithatë duhet ta kemi te gatshëm dhe te miratuar për vitin 2022 nga kuvendi i komunës. Unë ju ftojë që ta miratoni planin e KKSB-së për vitin 2022.

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar, atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar sa i përket pikës se pestë te rendit te ditës, e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit te ditës. Para se me mbyll mbledhjen e rregull, i kam dy fjalë për ti shtuar sa i përket kësaj mbledhje.

I nderuar kryetar i komunës z. Smajl Latifi, që ne emrin tim personal dhe te gjithë kolegeve te ju falënderoj për bashkëpunimin për këtë mandat që kemi pasur se bashku dhe gjithsesi urime dhe suksese për mandatin e ri, gjithashtu e shfrytëzoj rastin me i falënderua edhe nënkryetarin pastaj drejtoret e drejtorive komunale që gjithmonë kanë te gatshëm për bashkëpunim rreth kërkesave te qytetareve qoftë edhe ne orët e vona. Të nderuar kolege anëtar te kuvendit dua te ju falënderoj secilin veç e veç për kontributin e juaj që keni dhanë për këtë mandat e ne veçanti shefat e grupeve parlamentare duke filluar nga z Rasim Fazliu, pastaj Dervish Çadraku, Fehmi Cena dhe Ali Morina. Jemi munduar që te japim kontributin tonë per qytetaret që fatkeqësisht u përballëm ne vitin 2020 por edhe këtë vit me një situatë jo te mire që përfshiu gjithë botën, por ne si komunë mendoj se j kemi dalë mbarë duke u organizuar dhe duke ju dalë ne ndihmë qytetareve tanë brenda mundësive tona. Pra ju falënderoj te gjithëve dhe meqenëse jemi ne mbledhjen e fundit ju falënderoj te gjithëve për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin që kemi pasur gjate kësaj kohë për 4 vite që ne formën me te mirë te mundshme jemi munduar me dhanë kontributin për qytetaret tanë. Pra edhe njëherë dua te uroj kryetarin për mandatin e ri dhe suksese më tutje. Tani ne shenjë respekti do ti ftojë për fjalë rasti edhe shefat e grupeve.

Rasim Fazliu – Përshëndetje te nderuar kolegë, fillimisht dua te ju falënderoj te gjithëve për këto 4 vite që kemi qenë ne nivel detyre dhe mund te themi lirisht se anëtarët e kuvendit komunal te Rahovecit, vërtet kanë qenë anëtarë te kuvendit dhe i kanë ngjaje një kuvendi ashtu siç duhet me pas me një edukatë te plotë me mirësjellje duke i mirëkuptuar por edhe gjithmonë duke u interesuar dhe duke punuar për te mirën e qytetareve

te komunës se Rahovecit. Gjithashtu e falënderoj edhe kryetarin bashke me drejtorët që janë prezentë për punën dhe mirëkuptimin që kanë pasur me neve, kështu që me tepër nuk do të flas pasi edhe zonja Rukije ne fillim napolitësoj te gjithëve, kështu që faleminderit shume.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për te gjithë koleget anëtar te kuvendit e gjithashtu edhe gjithë ekzekutivin. Mendoj që ky legjislacion ka qenë mjaft konstruktiv falë punës me përkushtim që kanë bërë anëtarët e kuvendit dhe pjesa e qeverisë komunale sigurisht pasi ka qenë një bashkëpunim i mirë dhe kurdo që ka bashkëpunim te mirë atëherë sigurisht se sjell edhe rezultate te mira. Kjo është meritë e gjithë neve e veçanërisht edhe e kryesuesit i cili ka qenë mjaft konstruktiv. Ne fund dua që ti uroj ata që janë këtu dhe kanë fitue te drejtën që me marr pjesë ne legjislacionin e ri se pari shëndet dhe punë konstruktive që interesat e qytetareve ti kenë parasysh gjithçmos sepse mbi te gjitha se pari është interesi qytetar dhe gjithashtu edhe te tjerëve gjitha te mirat ne punët e tyre ne jete.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, mendoj se për mua ishte një përvojë e mirë dhe interesant e sigurisht kontribut dhënëse e te qenit delegat për këto 4 vite shkuan. Unë nuk do të jem asamblist ne legjislaturën e re por do të jem diku për me dhanë kontribut prape ne interes te qytetareve, kështu që te gjithë ata kolegë që janë zgjedh ju dëshiroj prape suksese dhe gjithashtu shume suksese i dëshiroj edhe kryetarin z. Smajl Latifi për 4 vitet e ardhshme që njëkohësisht e falënderoj edhe për bashkëpunimin dhe gjithë delegatet e grupeve politike pa dallime për bashkëpunimin që kemi pasur gjithmonë ne interes te qytetareve për çështje te rëndësishme, një falënderim shkon edhe për udhëheqësit e grupeve politike e gjithashtu edhe drejtorët me te cilët kemi pasur bashkëpunim dhe një falënderim i veçantë sigurisht edhe për kryesuesin që ka qenë ne nivel te detyrës dhe na ka mundësuar që ne te punojmë dhe te japim kontributin tonë sa me te mirë[si delegat. Pra suksese te gjithëve ne punën tuaj.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolegë asamblistë. Sinqerisht me vjen keq që këtë mandat po e mbyllim pa kolegun tonë, te ndjerin z.Astrit Thaqi. Sinqerisht dua te ju falënderoj te gjithëve secilin veç e veç për kontributin angazhimin dhe bashkëpunimin që kemi pasur gjate këtyre katër viteve, gjithashtu falënderim i veçantë shkon edhe për kryesuesin për një bashkëpunim te ngushtë, kryetarin, drejtorët e drejtorive e veçanërisht anëtarët e grupi tim te aleancës për një bashkëpunim te ngushtë qe kemi pasur gjate këtyre 4 viteve. Faleminderit shume.

Kryesuesi – Faleminderit te gjithëve, tash krejt ne fund e ftojme kryetarin aktual dhe kryetarin e ardhshëm që do te udhëheq komunën tonë për 4 vitet e ardhshme z. Smajl Latifi.

Kryetari – Unë ju falënderoj edhe njëherë nga zemra te gjithëve, kryesuesin e kuvendit te komunës, anëtarët e kuvendit te komunës, përgjegjësit e grupeve politike, monitoruesit që e kanë përcjell me vëmendje qofshin nga Ministria e Pushtetit Lokal apo edhe nga organizatat jo qeveritare, shoqëria civile, OSBE-ja ,po ashtu dua që ta falënderoj ekipin tim që kemi bashkëpunua jashtëzakonisht shume dhe i kam sfiduar unë vet por nuk kanë qenë pak te sfiduar edhe nga anëtarët e kuvendit te komunës nga nënkryetari dhe secili drejtor veç e veç që i falënderoj për bashkëpunim dhe kurajon që e kanë pasur. Ne kemi pasur sfida që ne fillim dhe unë i falënderoj për këtë pasi si sfide kemi pasur zgjedhjen e kryesuesit edhe pse nuk është zgjedhur ne kushte normale por ka mbërri me fitua respektin e te gjithë anëtareve te kuvendit. Pra kryesuesi me punën dhe respektin që e ka kultivue ne vazhdimësi ka mbjelle farën e besimit te secili anëtar i kuvendit te komunës se Rahovecit. Pra është një shembull i mirë që kështu duhet te funksionojnë kryesuesit që ne fakt duhet me reflektua edhe paanshmëri dhe me i krye punët dhe përgjegjësit si duhet. Unë besoj që kryesuesi ne bashkëpunim me kuvendin e komunës e ka krye punën ashtu si duhet dhe e përgëzoj për punën që ka krye, ndërsa sa i takon raporteve ekip qeverisës kryetar i komunës kuvend i komunës atëherë do te ishte e panatyrshme me thanë që na nuk kemi pasur asnjë sfidë apo përballje ne ballafaqim me ju sepse ndryshe do ishim ne ndonjë vend komunist po ne kemi qenë ne kuvend te komunës dhe kemi marr vërejtje këshilla

plotësim por edhe kritika e që po besoj që gjat gjithë kësaj periudhe kemi qenë jemi përpjekur me reflektua angazhim përkushtim dhe jo inate. Pra neve nuk na ka ardh mirë kur dikush na ka kritikua ne sallë mirëpo menjëherë pas mbledhjes kemi ndërmarr veprime te caktuara që me u sigurua që po i dëgjojmë me vëmendje ata që japin vërejtje apo që kritikojnë dhe kjo na ka shërbye pastaj gjate gjithë procesit apo periudhës 4 vjeçare. Jemi ballafaquar me shume sfida te renda dhe panjohura për ne siç është pandemia edhe tani ju shpreh ngushëllimet e mia edhe ne emër te qytetareve që kemi 78 raste te vdekjeve ne komunën e Rahovecit si pasoj e Covid-19 dhe ka edhe raste te paregjistruara siç është rasti edhe vllau im që ka qenë shume e vështir siç ka qenë edhe humbja e asamblistit z.Astrit Thaqi që nuk ka qenë humbje jo vetëm e PDK-së por për gjithë komunën e Rahovecit por edhe me gjerë. Por natyrisht humbjet që i kemi përjetua dhe humbjet që i kemi pas nuk kanë qene te lehta me u përballua por ne kemi gjetur force te përbashkët me i përballua këto. Ky kuvend i komunës ka marr shume vendime te rëndësishme ka miratuar rregullore, ka bërë plotësim ndryshim te rregulloreve te gjitha me qellim që ti shërbejnë rregullimit te jetës apo që kanë shërbye me rregullua shume problematika që natyrisht që detyra e institucioneve është qe me i krye dhe asnjëherë nuk kemi pasur raste problematike që te na shkoj mendja që te mos miratohet një rregullore apo një vendim i rëndësishëm për te mirën e qytetareve. Ky kuvend ka miratuar disa herë buxhetin apo për 4 vite rrëshe e ka miratuar buxhetin dhe natyrisht nuk është lehtë aspak te miratohet një buxhet edhe pse i nënshtrohet krejt procedurave pasi jemi komune që kemi shume probleme dhe nevoja e kërkesa dhe i falënderoj publikisht për rendësin që ja keni dhënë komunës si anëtar te kuvendit që ne mesin e komunave te para ta votojmë buxhetin për vitin 2022. Ne normalisht që kemi pasur edhe plot vendime te cilat kane te bëjnë me situata te cilat i kanë bërë nder, pasi ne kemi pasur nje qëndrim te caktuar gjate kësaj periudhe kur dikush është ftuar ne gjykatën e Hagës dhe ky kuvend i komunës kanë nxjerr deklaratë kur drejtuesit e UÇK-së janë thirrur ne Hagë apo janë ngritur aktakuza apo janë thirrur ne cilësinë e dëshmitarit. Pra ky kuvend ka nxjerrë deklaratë dhe ka mbajtur qëndrim pavarësisht dikush mundet me thanë se nuk janë kompetenca te komunave por ne kemi dëshmuar se komuna e Rahovecit beson ne drejtësinë e luftës çlirimtare që e ka bo UÇK-ja dhe dihet se kush është agresori dhe kush është viktima. Ky kuvend ka miratuar vendime te cilat i kanë vlerësuar njerëzit e caktuar, pra e kanë vlerësuar Tomor Kotorrin nga Përmeti, ambasadorin Qemal Minxhozi por ka ndërmarr edhe veprime te tjera që sigurisht se komunës tonë i kane dhënë mundësi me u lidh edhe me personalitete por edhe me iniciativa te caktuara te cilat veç munden me i sjell dobi komunës. Pastaj ky kuvend i komunës ka ndërmarr edhe plot veprime sigurisht me ekzekutivin e komunës dhe kryetarin e Komunës dhe besoj që jemi nder komunat me te mira që ka Republika e Kosovës. Sigurisht se ka pasur ndonjëherë telashe mirëpo nuk ka pasur situata frenuese që mund te ketë patur ne kuvende te tjera te Kosovës siç ishte rasti me situatën problematike ne Prizren dhe Malishev, gjithashtu suate problematike ne miratimin e buxhetit kemi pasur edhe ne Suharekë. Pra anëtarët e kuvendit te komunës kanë treguar vetëdije jashtëzakonisht te lartë te cilën e kanë shprehur dhe dëshmuar që Kuvendi i Komunës nuk është frenues dhe nuk ndalon procese zhvillimore pozitive që janë ne interes te komunës. Kështu që këtë e ka dëshmuar kuvendi jonë i komunës se Rahovecit dhe unë jam falënderues edhe për secilin dhe ndjenjën e larte te përgjegjësisë që kanë dëshmuar përgjegjësit e grupeve politike si Rasimi, Dervishi, Fehmi, Alia por edhe një gatishmëri por edhe vullnet individual që e kanë dëshmuar Besniki Bajrami por edhe Trajko që ka qenë pjese e secilit proces që edhe kontributi i tij ka shkuar ne dobi te asaj që është interes i përgjithshëm. Pra i kam vlerësimet me te mira për kuvendin e komunës dhe i uroj te gjithë ata që kanë fatin dhe mundësin me punua bashke me ne gjate këtij mandati 4 vjeçar dhe sigurisht se do ta ruajmë miqësinë me ata që nuk janë futur fare apo nuk kanë mbërri me sigurua ulëse ne kuvendin e komunës. Tash ne po hymë ne një etapë te re pasi tash kam edhe përvojën pasi ne mandatin e parë kemi pasur shume probleme por nga viti 2017 e tutje nuk ka ndodhur edhe pse kemi kaluar shume sfida me kuvendin por nuk kam ndonjë përvojë te hidhur te asaj kohe por përvoja gjate këtij mandati 4 vjeçare ka qenë shume me

pozitive dhe nivel shume me i lartë i komunikimit dhe sigurisht se kryetari i komunës e ka kuptua se me kuvendin e komunës duhet me qenë me i afërt dhe bashkëpunues, pasi ne fillim kam mendue se krejt punët e komunës mundet me i krye kryetari i komunës me ekipin e tij. Kurse tash jemi ne një etape te re dhe me anëtarët figurativisht te vjetër te kuvendit që do te jenë edhe ne përbërjen e re do te kemi një komunikim shume me në nivel për shkak se ata kanë një përvojë te duhur dhe vetëm me ata që hynë për herë te parë ne proces do te kemi mundësi te komunikimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë e kuvendin te komunës. Faleminderit te gjithëve, juve kryesues ju përgëzoj për punën dhe gjithashtu ekipit tim për punën përkushtimin sfidat që i kemi kalua bashke. Kështu që edhe njëherë urime dhe shume suksese ne detyrën tuaj te re.

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar për vlerësimin korrekt dhe te drejtë, ju uroj shëndet dhe suksese ne mandatin e ri. Te nderuar kolegë ju përshëndes përzemërsisht dhe gjitha te mirat për ju!

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

